



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE, LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 654 Prot.

Tiranë, më 12/11/2013

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për eliminimin e vonesave të pagesës së ndihmës ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuar.

Drejtuar: z. Erjon VELIAJ
MINISTËR I MIRËQËNIES SOCIALE DHE RINISË

TIRANË

Për dijëni: z. Shkëlqim CANI
MINISTËR I FINANCAVE

TIRANË

I nderuar z. Ministër!

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përmbushje të qëllimit të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin dhe bazuar në kompetencën që i jepet në bazë të shkronjës “F”, të pikës 1, të nenit 32, të këtij ligji, për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështje që lidhet me diskriminimin, parashtron sa më poshtë vijon:

Komisioneri në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, është duke realizuar ditë të hapura në disa bashki, në kuadër të projektit “Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të diskriminuar”, të mbështetur financiarisht nga Zyra e Kooperacionit Zviceran në Tiranë. Gjatë takimit në qytetin e Lezhës, Komisioneri ka marrë një numër të lartë ankesash lidhur me mospagesën e ndihmës ekonomike dhe pagesës mujore të personave me aftësi të kufizuar.

Nga informacionet që institucioni ynë ka grumbulluar nga pikat e kontaktit në bashki dhe komuna, rezulton se kjo problematikë nuk është e kufizuar vetëm në qytetin e Lezhës. Në



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

